



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ejona” Sh.P.K. të datës 02.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit 616-23-4207-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ejona” Sh.P.K. e datës 02.04.2024 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit 616-23-4207-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 27.03.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Ejona” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ejona” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 02.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 27.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit 616-23-4207-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "AK perseri shpall fitues OE per te cilin Paneli i OSHP-seka konstatuar se nuk i ka plotesuar Kerkesat dhe mundesite teknike e profesionale ne DT. Per kete pretendim tashme ekziston Vendimi i OSHP-se nr 554/23. Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kërkesat e pikës 3 ,Kërkesat dhe mundësit teknike e profesionale te DT, pasi OE i rekomanduar nuk i ka dorzuar Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, çertifikata këto të cilat nuk përkojnë me kërkesat e DT për mirëmbajtje të ashensorë, e cila është kërkesë e rregullores se cituar, po ashtu, parashihet se secili anëtar i grupit duhet të dëshmojnë standardet përkatëse, kërkesë kjo e cila është e ndërlidhur me nenin 70 të LPP dhe me cilësit që duhet të posedojë OE, andaj, konform nenitt 26.6 të RRPP, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e përcaktuar në Dosje të Tenderit. Kjo çështje është e sqaruar edhe në interpretimin e nxjerru nga KRPP më 22.06.2023, i renditur me nr. rendor 29, dhe i cili është i publikuar ne ueb faqen e eprokurimit".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se OSHP përmes Panelit Shqyrtues ka marrë vendimin 554/23 përmes të cilit është miratuar ankesa e parashtruesit "Ejona" Sh.P.K. ndërsa aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim. Përmes këtij vendimi ndër të tjera është konstatuar se tenderuesi i rekomanduar nuk i ka dorzuar Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, çertifikata këto të cilat nuk përkojnë me kërkesat e DT për mirëmbajtje të ashensorë. Raporti i vlerësimit mbi bazën e të cilit është hartuar edhe letra përkatëse standarde si pjesë e njoftimit mbi vendimin kundër të cilit është drejtuar kjo kërkesë për rishqyrtim, nuk është në përputhje me vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 554/23. Për këto arsye është gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara ndërsa me rastin e rivlerësimit, komisioni i ri vlerësues mund të shfrytëzoj edhe mundësinë ligjore për të kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP nëse ekziston nevoja për një sqarim të tillë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.04.2024

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.